



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 143, Datë 24.09.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A., ME NR. 274, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 35, DATË 04.03.2015.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma d) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma e); nenit 5, pika 1, gërma e); nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 24.09.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 89/10 Prot, datë 13.09.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

- Shoqëria “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., është mbajtëse e licencës me nr. 274, Seria T15 të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të bordit të ERE-s, nr. 35, datë 04.03.2015, me afat 5 vjeçar. Afati i kësaj licence përfundon në datën 04.03.2020.
- Shoqëria “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 529, datë 02.09.2019, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Aplikanti ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës, në zbatim të afateve të parashikuara në nenin 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, jo me vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Aplikimi i shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

“Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor” neni 9, pika, gërma b, (mungon Akti i Themelimit).

“Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike” neni 9, pika 4.8, gërmat “a” (mungon sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh sipas viteve).

Neni 9, pika 4.8, gërmat “b” (mungon kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie). Neni 9, pika 4.8, gërmat “c” (mungon lista e kontratave të mëparshme, të realizuara, nëse ka pasur);

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e Energjisë Elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, nr. 274, seria T15 të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 35, datë 04.03.2015, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti